



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13/2019 regjistër (JR)
Datë 27.02.2019

Nr. 5 i vendimit
Datë 13.03.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 13.03.2020, ditën e premte, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 90, datë 20.12.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova, me funksionin prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, pretendimet e subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Adnand Kosova (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, mbante detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI i dërgoi Komisionit më datë 16.11.2017, një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
(i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
(ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
(iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
(iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
(v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, DSIK-ja, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, më datë 27.10.2017 i ka përcjellë Komisionit raportin¹, duke konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Raporti po ashtu konstaton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk ka informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.
4. Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara dhe të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe rishikimit të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor. Bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, më datë 12.04.2018, Komisionit i është përcjellë raporti i hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të

¹ Deklasifikuar plotësisht nga DSIK-ja me vendimin nr. {***}, datë 27.09.2018.

tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 90, datë 20.12.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Me vendimin nr. 90, datë 20.12.2018, bazuar në nenet 51, 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova. Vendimi është marrë bazuar në konkluzionet e Komisionit për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, përmbledhur si në vijim.

6.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm pasi ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, si dhe nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat e pasurisë në vite në mënyrë të vazhdueshme.

6.2. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë situatën faktike, si dhe të japë shpjegime: a) për shumën e përfituar nga shitja e apartamentit në Korçë, në vlerën 2.500.000 lekë, përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë; b) për kaparin e marrë në vitin 1998 si paradhënie për shitjen e shtëpisë në Korçë; c) për mungesën e detyrimit ligjor për pagimin e tatimit për kaparin e marrë në shkurt të vitit 1998. Sipas Komisionit, gjatë hetimit u provuan pretendimet e subjektit të rivlerësimit, përveç deklarimeve noteriale të dhëna nga blerësi i apartamentit në Korçë, vlera provuese e të cilave është e pakonsiderueshme në vlerësimin e Komisionit. Në vijim, Komisioni ka argumentuar se ka krijuar “bindjen e brendshme se vlera e shtëpisë së shitur në Korçë ka qenë 2.500.000 lekë, nga të cilat 1.500.000 lekë subjekti i rivlerësimit i ka marrë si kapar në shkurt të vitit 1998 nga blerësi i këtij apartamenti”². Pavarësisht detyrimit ligjor për tatimin e të ardhurave në momentin kur ato realizohen dhe mungesës së parashikimit ligjor për pagimin e tatimit për kaparin e marrë në shkurt 1998, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e pasqyrimit në kontratën e vitit 2002 të kaparit të përfituar në vitin 1998³.

6.3. Sipas Komisionit, pasaktësia prej 1.500.000 lekësh në çmimin e kontratës së shitjes së pasurisë në Korçë, e marrë në vitin 1998 në formën e kaparit dhe që nuk është pasqyruar në kontratën e vitit 2002, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe nuk cenon figurën e prokurorit apo besimin e publikut të drejtësisë. Diferenca negative [prej 476.179 lekësh], e konstatuar në analizën financiare të vitit 1998, nuk është në masën që cenon besimin e publikut. *Natyra e analizës financiare - shprehet Komisioni - është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e likuiditetit në këtë masë nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*⁴.

² Shih paragrafin 63 të vendimit të Komisionit.

³ Shih paragrafin 64 të vendimit të Komisionit.

⁴ Paragrafi 74, faqe 12 dhe paragrafi 86, faqe 14 e vendimit të Komisionit.

6.4. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimi ka arritur nivel të besueshëm, duke qenë i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës. Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

6.5. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues dhe është vlerësuar “i aftë” profesionalisht. Komisioni konstaton se nuk u gjet asnjë tregues që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

III. Shkaqet e ankimit

7. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”), në konsideratë edhe të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”)⁵, më datë 13.02.2019 ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 90, datë 20.12.2018, për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar. Sipas Komisionerit Publik, një vlerësim korrekt i provave të çështjes dhe zbatimi i kuadrit ligjor duhet të çojë në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
8. Në ankimin e tij, Komisioneri Publik parashtron se, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut VII të ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit është i cenueshëm, pasi nuk u përgjigjet provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e të ardhurave, duke u përpjekur të deklarojë në mënyrë të rreme apo duke anashkaluar parashikimet ligjore, me qëllim kryerjen e evazionit fiskal. Kjo situatë dikton aplikimin e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik, ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, nuk krijohet bindja se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim konfirmimi në detyrë sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) marrjen në konsideratë të shkaqeve të ankimit dhe, pas hetimit të plotë për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të gjykimit të çështjes, në bazë të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendoset ndryshimi i vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit dhe shkarkimi i tij nga detyra.
9. Në konkluzionet përfundimtare të parashtruara në seancën e datës 03.03.2020, Komisioneri Publik, duke iu përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, konstatoi se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkakut të ankimit. Në vlerësim edhe të përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik, në kërkimin përfundimtar të ankimit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi rezulton me mungesë të burimeve financiare dhe nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar prej tij dhe personave të lidhur me të, siç parashikon neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, shkronja “b” dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik i kërkoi

⁵ “Rekomandim për paraqitje ankimi”, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 01.02.2019, dhe protokolluar pranë Institucionit të Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 01.02.2019.

përfundimisht Kolegjit që, bazuar në nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

A. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

10. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të parashtruara nga Komisioneri Publik në ankimin e datës 13.02.2019, paraqiten si më poshtë.

10.1. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 98 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, rrethanat janë të tilla që çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të shpjegojë bindshëm origjinën e ligjshme të burimit prej 1.500.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie.

i) Lidhur me origjinën e ligjshme të shumës prej 1.500.000 lekësh:

a) pasuritë e subjektit të rivlerësimit të deklaruara në deklaratën *vetting* duhet t’i nënshtrohen një kontrolli/vlerësimi të hollësishëm, për t’u siguruar që funksionari zyrtar është një person me integritet dhe për të vendosur nëse e gjithë pasuria është e ligjshme. Nga kontrolli/vlerësimi nuk mund të përjashtohen pasuritë që janë krijuar para vitit 2003, të cilat duhet të analizohen rast pas rasti në kuptim të vlerësimit të shpjegimit bindshëm dhe të provave mbështetëse lidhur me origjinën e ligjshme⁶;

b) nuk provohet me prova të besueshme ekzistenca e burimit prej 1.500.000 lekësh, për blerjen e kësaj pasurie (sikurse është deklaruar në deklaratën *vetting*), e pretenduar si e prejardhur nga shitja e mëparshme e apartamentit në Korçë;

c) pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbeten në nivelin deklarativ dhe nuk mund të konfirmojnë, pa qenë në harmoni me prova të tjera, faktet e deklaruara, pasi deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2003 dhe deklarata noteriale e datës 20.08.2018, e cila rezulton e paraqitur pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, bien ndesh me kontratën e shitjes së apartamentit në Korçë, të datës 10.06.2002;

ç) në kontratën e shitblerjes së datës 10.06.2002, e lidhur 4 vjet pas pagesës së kaparit të pretenduar, është specifikuar si vlerë e shitjes së pasurisë shuma 1.000.000 lekë. Në të nuk pasqyrohet marrëdhënia e pretenduar e kaparit apo shuma 1.500.000 lekë, si pagesë e marrë nga blerësi, z. E. K., siç pretendon subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 18.09.2018.

ii) Lidhur me shmangien e pagesës së tatimit për shumën 2.500.000 lekë – përfitimi i kaparit nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 1998, përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes së apartamentit në Korçë, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për subjektin e rivlerësimit. Mospërfshirja e kësaj vlere në çmimin e deklaruar në kontratën e shitblerjes së këtij apartamentit në vitin 2002, ka bërë që të shmanget pagimi i

⁶ Lidhur me këtë çështje, Komisioneri Publik rithekson dhe bashkohet me qëndrimin e arsyetuar në Rekomandimin e ONM-së, duke cituar paragrafin e dytë të pikës 3 të këtij dokumenti (<http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/02/7.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-90-dat%C3%AB-20.12.2018-compressed.pdf>) – shih paragrafin 11.8.1, faqe 6 të ankimit të datës 13.02.2019.

detyrimin tatimor për shumën 1.500.000 lekë, që përbënte kaparin e deklaruar të marrë paraprakisht.

iii) *Sa i përket mundësisë financiare në vitin 1998 për pagesën e pretenduar në vlerën 1.900.000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur aftësi pagueuse për të justifikuar vlerën e pasurive të deklaruara, pasi të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin “{***}” nuk mund të merren në konsideratë sepse janë konfirmuar me vlerë të përafërt nga institucioni dhe kanë efekt të reduktuar në ndryshimin e balancës negative. Për më tepër, nëse do të konsiderohen edhe shpenzimet e jetesës, sipas deklarimit të bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit, diferenca negative do të thellohej më tepër.*⁷

11. Në konkluzionet përfundimtare, më datë 03.03.2020, lidhur me pasurinë apartament banimi në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioneri Publik parashtroi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës paradhënie prej 1.500.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Kjo shumë, vëren Komisioneri Publik, nuk rezultoi as në kontratën e shitblerjes. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm, në përputhje me Nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.

IV. Shpjegimet dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit

12. Përkundër sa pretendoi Komisioneri Publik në ankimin e datës 13.02.2019, subjekti i rivlerësimit parashtroi se Komisioni ka zbatuar me korrektësi dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Civil, që përcaktojnë burimin e provave, rregullat për paraqitjen, pranimin apo mospranimin e tyre, si dhe ka kryer një analizë të kujdesshme të provave, duke i vlerësuar ato të mjaftueshme për të konkluduar se ai e justifikon pasurinë me të ardhura të ligjshme.

12.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, kontrata e shitjes së apartamentit në Korçë i plotëson të gjitha elementet e parashikuara nga nenet 750⁸ e 83⁹ të Kodit Civil. Çmimi i shitjes është i vetmi element i pasaktë. Pavarësisht rëndësisë që ka, çmimi nuk sjell pavarshmërinë e kontratës. Çmimi në kontratën e shitjes së banesës në Korçë është në përputhje me karakteristikat e përcaktuara nga neni 707¹⁰ i Kodit Civil, por konstatohet lehtësisht se nuk është i drejtë, pasi ndjeshëm është nën çmimin real të vlerës së banesës

⁷ Në ankim, Komisioneri Publik specifikon se në analizën financiare të subjektit janë marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme të cilat plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet për jetesë të kryera nga subjekti dhe familja, blerja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kursimet e deklaruara gjendje “cash” dhe gjendjet në llogaritë bankare. – shih paragrafin 11.10.3, faqe 7, të ankimit të datës 13.02.2019.

⁸ Neni 750 i Kodit Civil parashikon se: “Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme”.

⁹ Neni 83 i Kodit Civil parashikon se: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë”.

¹⁰ Neni 707 i Kodit Civil parashikon se: “Në qoftë se palët nuk e kanë caktuar çmimin, as nuk janë marrë vesh për mënyrën e caktimit të tij, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente publike, prezumohet se palët kanë dashur t’i referohen çmimit të zbatuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës. Kur është fjala për sende që kanë çmim burse apo tregu, çmimi caktohet në bazë të listave të tregut të vendit ku do të bëhet dorëzimi, ose nga ato të vendit që është më afër tij. Në qoftë se çmimi është caktuar mbi bazën e peshës së sendeve, në rast dyshimi ai duhet të caktohet në bazë të peshës neto. Palët mund t’ia besojnë caktimin e çmimit një të treti, të emëruar në kontratë ose që mund të emërohet më vonë”.

në Korçë. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka sqaruar, mbështetur në nenin 681¹¹ të Kodit Civil pse palët kanë caktuar çmimin në vlerën 1 000 000 lekë në kontratën e shitblerjes së banesës në Korçë dhe sjelljen e tyre në tërësi para dhe pas përfundimit të kontratës.

12.2. Përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim lidhur me origjinën e ligjshme të shumës prej 1 500 000 lekësh, në mungesë të provave bindëse për marrjen e kaparit, subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj parashitroi sa vijon.

12.2.1. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, dokument zyrtar që përbën një fillim prove me shkresë, ka deklaruar çmimin e vërtetë të shitjes. Sikurse rezulton nga ky dokument, vlera 2 500 000 lekë përfaqëson vlerën reale të shitjes së banesës, në dallim nga çmimi 1 000 000 lekë i përcaktuar në kontratë. Pranimi i provave me dëshmitarë për të sqaruar rrethanat që kanë çuar palët në pasqyrimin e vlerës 1 000 000 lekë në kontratën e shitblerjes të datës 10.06.2002, parashikohet nga neni 233¹², shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, sa i përket fillimit të provës me shkresë. Në kontratën me shkrim të kaparit, palët kanë shprehur lirshëm vullnetin dhe kanë pranuar pasojat e saj të parashikuara nga nenet 601¹³ e 602¹⁴ të Kodit Civil. Kjo kontratë është pasuar nga kontrata e shitblerjes së banesës, formalizuar me akt noterial, sipas kërkesave të ligjit. Palët nuk e kanë ruajtur shkresën ku kanë përcaktuar vlerën e kaparit, duke mos e konsideruar të rëndësishme, pasi kanë një kontratë shitblerjeje para noterit, të lidhur pas datës kur është dhënë kapari, pasi nuk ka pasur pretendime në lidhje me shitblerjen e banesës, si dhe pasi ka ndodhur 22 vjet më parë. Kodi i Procedurës Civile parashikon në nenin 233 si provohet kryerja e një veprimi juridik të mëparshëm kur dokumenti që kërkohet nga ligji për provimin e veprimit juridik ka humbur pa fajin e palës. Lidhja e kontratës së kaparit është vërtetuar plotësisht nga dëshmitari E. K. nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 20.08.2018, në mbështetje të së cilës janë edhe deklaratat e tjera të administruara gjatë procesit, si deklaratat noteriale të datës 08.12.2018, të datës 10.12.2018 dhe të datës 11.12.2018.

12.2.2. Lidhur me dyshimin e Komisionerit Publik për ekzistencën e kontratës së kaparit, për shkak të mungesës së një dokumenti shkresor, përveç deklaratës fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratës noteriale të dhënësit të kaparit, subjekti i rivlerësimit sollti në vëmendje të trupit gjykues të Kolegjit parashikimet e Kodit Civil që mbështesin parimin e lirisë së formave. Sipas subjektit të rivlerësimit, kapari nuk duhet të ngatërrohet me paradhënien që, sipas Komisionerit Publik, duhej të shënohej në

¹¹ Neni 681 i Kodit Civil parashikon se: “Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”.

¹² Neni 233 i Kodit të Procedurës Civile “Rastet e lejimit të provës me dëshmitarë” parashikon se: “Rregullat e caktuara në dy nenet e mësipërme nuk zbatohen dhe lejohet prova me dëshmitarë: [...] b) kur ka një fillim prove me shkresë. Quhet fillim prove me shkresë çdo shkresë, që rrjedh nga ai, kundrejt të cilit drejtohet kërkimi dhe nga përmbajtja e së cilës del se fakti i pretenduar është pothuajse i vërtetë [...]”.

¹³ Neni 601 i Kodit Civil parashikon se: “Kapari quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t’i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetohet lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj”.

¹⁴ Neni 602 i Kodit Civil parashikon se: “Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kaparin, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për moszekutimin e kontratës është e detyruar t’i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe”.

kontratën e shitjes edhe vlera e dhënë si kapar. Paradhënia nënkupton pagesën e një kësti të parë, pra një ekzekutim i pjesshëm i kontratës, ndërsa kapari nënkupton një kontratë të veçantë me pasoja të mirëpërcaktuara në ligj. Në vetvete, kontrata e kaparit duhet të bëhet me shkresë për efekt provueshmërie dhe jo vlefshmërie.

12.2.3. Pretendimi i Komisionerit Publik se nuk provohen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për dhënien e kaparit, nuk përputhet me frymën e asnjë legjislacioni qoftë civil, penal apo edhe tatimor, pasi subjekti nuk ka pasur detyrimin të ruante shkresën e thjeshtë të përpiluar në kohën e lidhjes së kontratës së kaparit. Ngarkimi me barrën e provës duhet të bëhet nën këndvështrimin e proporcionalitetit të asaj që kërkohet të provohet, me kohën e kryerjes së veprimit dhe detyrimin që ka përcaktuar legjislacioni i kohës.

12.2.4. Sipas subjektit të rivlerësimit, është e qartë dhe lehtësisht e konstatueshme se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur prova nga çmuarja e të cilave deduktohet në mënyrë të plotë ekzistenca e dhënies së kaparit, të tilla si:

- i) deklarata e dhënësit të kaparit;
- ii) deklarata fillestare e pasurisë, e vitit 2003, nga e cila dalin pah tri të dhëna të rëndësishme, pasi:
 - a) tregohet çmimi i vërtetë i shitjes së banesës në Korçë, në vlerën 2.500.000 lekë;
 - b) burimi i të ardhurave për blerjen e pasurisë në Tiranë – shitja e apartamentit në Korçë dhe kursimet nga paga ka nënkuptuar shumë prej 1.500.000 lekësh, të marrë në formën e kaparit nga z. E. K. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky deklaram shpjegon qartë edhe kronologjinë e likuidimit të vlerës së banesës në Tiranë, fillimisht në muajin shkurt 1998 në vlerën 1.900.000 lekë (të përbërë nga 1.500.000 lekë të përfutuara në formën e kaparit dhe 400.000 lekë kursime) dhe në vlerën 6114 USD të likuiduar në muajin mars 2000 (të përbërë nga kursimet nga pagat);
 - c) nëse pagesa nga shitja e apartamentit në Korçë do të ishte marrë e gjitha në momentin e nënshkrimit të kontratës, në datën 10.06.2002, ky veprim do të kishte sjellë rritjen e pasurisë dhe pasqyrimin e kësaj rritjeje në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, gjë që nuk është deklaruar të ketë ndodhur;
- iii) çmimi real i shitjes së pasurisë në Korçë në vlerën 2.500.000 lekë është në proporcion të drejtë me çmimet e referencës të kohës kur është kryer veprimi juridik. Subjekti iu referua përgjigjes së datës 02.11.2008¹⁵ nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme Korçë, sipas së cilës vlera minimale e shitjes së një banese me sipërfaqe sa ajo e subjektit të rivlerësimit në vitin 1998 do të ishte në vlerën 1.913.534 lekë dhe në vitin 2002 në vlerën 2.346.765 lekë. Duke marrë në konsideratë që banesa gjendej në katin e parë të një pallati, buzë bulevardit “{***}”, në qendër të qytetit të Korçës dhe kishte për destinacion përdorimin për biznes, çmimi 2.500.000 lekë është i justifikueshëm.

12.2.5. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit argumenton se kontrata e shitblerjes së banesës në Korçë, në vlerën 1.000.000 lekë, nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, pavarësisht parashikimeve të neneve 750 e 83 të Kodit Civil, por ajo duhet të vlerësohet në harmoni me provat e tjera.

¹⁵ Shkresa nr. {***} prot.

12.3. Përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, që lidhen me shmangien e pagesës së tatimit për shumën 2.500.000 lekë, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtrori se:

12.3.1. Vlera e kaparit e marrë në vitin 1998 nuk përbënte të ardhur për vitin 2002 që të vendosej në kontratë për t'u detyruar të paguhej tatimi, pasi nuk ishte marrë në periudhën tatimore për të cilën duhet të bëhej deklarimi. Për këtë arsye, çmimi i shitjes së banesës në kontratën e datës 10.06.2002, është shënuar 1.000.000 lekë dhe jo 2.500.000 lekë (sa është shitur realisht), me arsyetimin se shitësi nuk tatohej për kaparin në shumën 1.500.000 lekë. Sipas legjislacionit të kohës [ligji nr. 8189, datë 30.01.1997 (në vijim "ligji nr. 8189/1997")]¹⁶ e ardhura nga kapari nuk tatohej pasi ishte nën vlerën 2.000.000 lekë. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit pretendon se argumentet që përmbahen në rekomandimin e ONM-së janë krejtësisht të pabazuara, pasi nuk mbështeten në asnjë provë apo indicie se e gjithë shuma është marrë në vitin 2002, kur është lidhur kontrata e shitblerjes, kurse çmimi prej 1.000.000 lekësh, pasqyruar në kontratë, ka pasur për qëllim shmangien e tatimeve. Në kundërshtimin e tij, subjekti i rivlerësimit argumenton se vlera e detyrimit për pagesën e tatimit në vitin 2002, për shumën 2.500.000 lekë, ishte 25.000 lekë (1%). Kjo vlerë është e papërfillshme krahasuar me vlerën e shitjes së banesës.

12.3.2. Në seancën gjyqësore të datës 26.02.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës konfirmimin bankar që provon kryerjen më datë 28.01.2020 të pagesës së tatimit¹⁷.

12.4. Përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, që lidhen me pamundësinë financiare për pagesën e pretenduar, subjekti i rivlerësimit parashtrori se diferenca negative që rezulton nga analiza financiare e Komisionit dhe e pasqyruar në vendim nuk është e saktë. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit paraqiti një analizë të hollësishme financiare mbi të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e mundshme përgjatë periudhës 1986 – 2017.

13. Në konkluzionet përfundimtare të mbrojtjes së tij, të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 03.03.2020, subjekti i rivlerësimit theksoi se:

- ka shpjeguar bindshëm dhe me prova të pakundërshtueshme që për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vlerën 19.600 USD, ka pasur të ardhura të ligjshme të siguruara nga shitja e banesës në Korçë dhe nga kursimet nga paga;
- nuk ka shmangur tatimin për shumën e përfituar në vlerën 1.500.000 lekë, në formën e kaparit, pasi ligji i kohës kur është përfituar kjo shumë, parashikonte se të ardhurat nga shitjet e pasurisë së paluajtshme dhe çdo e ardhur tjetër në vlerën nën 2.000.000 lekë, nuk tatoheshin. Në vitin 2020, ka kryer pagesën e tatimit për pjesën e detyrimit të prapambetur për shitjen e banesës në Korçë, në vlerën 20.000 lekë;
- të ardhurat e ligjshme të siguruara nga puna e tij që i përkasin një periudhe 34-vjeçare, të pandërprerë në sistemin e drejtësisë, dhe nga puna prej 25 vitesh e bashkëshortes së

¹⁶ "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", ndryshuar me ligjin nr. 7823, datë 18.5.1994, ligjin nr. 7897, datë 2.2.1995 dhe ligjin nr. 8091, datë 21.3.1996".

¹⁷ Fatura nr. {***}, datë 28.01.2020, për shumën 24.620 lekë (në total 24.820 lekë) Banka Credins, me përshkrimin "Kontr., rep. {***}, kol. {***}, Tat.Mba.Buri. Dhjetor 2019".

tij, duke përjashtuar të ardhurat nga shitja e banesës në Korçë, janë dukshëm më të larta kundrejt pasurive.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

I) *Juridiksioni i Kolegjit*

14. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit dhe të Komisionerit Publik kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

II) *Legjitimimi i ankuesit*

15. Komisioneri Publik, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

III) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, duke qenë se ka për objekt shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 90, datë 20.12.2018, për subjektin e rivlerësimit Adnand Kosova, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 06.02.2020, 26.02.2020 dhe 03.03.2020 në prani të palëve, përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, avokatit Sokol Hazizaj¹⁸, si dhe të publikut. Vendimi përfundimtar i Kolegjit u shpall publikisht në formë elektronike, në faqen zyrtare në internet të Kolegjit, në datën 13.03.2020¹⁹.
17. Trupi gjykues i Kolegjit në seancën e parë gjyqësore publike, të zhvilluar më datë 06.02.2020, i shtroi Komisionerit Publik dy pyetje. Së pari, meqenëse ankimi (sipas paragrafit 9) ushtrohej për të tria kriteret e rivlerësimit të qartësonte nëse qëndronin ende kërkimet e tij për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

¹⁸ *Seanca gjyqësore e datës 03.03.2020, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, u zhvillua pa praninë e përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit*

¹⁹ *Me vendimin nr. 6, datë 11.03.2020, Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit vendosi që për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 në vend dhe në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, të kufizojë veprimtarinë dhe shërbimet e tij. Në pikën 3 të këtij vendimi u përcaktua që vendimi përfundimtar për subjektin e rivlerësimit të shpallet publikisht në formë elektronike, në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit (www.kpa.al), në datën dhe orën e caktuar. Shih: <http://kpa.al/njoftim-278/> dhe <http://kpa.al/njoftim-vendimi-45/>.*

18. Së dyti, trupi gjykues kërkoi të konfirmonte njohurinë dhe qëndrimin e Komisionerit Publik lidhur me denoncimin e prokurores pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, A. P., i cili i ishte përcjellë njëkohësisht prej saj Komisionerit Publik dhe ONM-së²⁰. Denoncuesja pretendon për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona që kanë lidhje familjare të afërt me të dhe të cilët duhet të ishin deklaruar prej tij në formularin për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016²¹.
19. Në përgjigje të pyetjeve të shtjelluara më sipër, Komisioneri Publik u shpreh se vlerëson që ankimi të jetë i hapur për të tria kriteret e rivlerësimit, duke qenë se pas depozitimit të ankimit për një kriter janë paraqitur denoncime që lidhen me dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit. Komisioneri Publik parashtroi se nëse nuk do të përmbushen këto shkaqe ankimi, ai do të tërhiqej.
20. Për sa i përket pyetjes së dytë, Komisioneri Publik parashtroi se denoncimi i prokurores A. P., është paraqitur pranë institucionit të përfaqësuar prej tij më datë 17.12.2019, pas depozitimit të ankimit më datë 13.02.2019. Komisioneri Publik shprehu pamundësinë për të mbledhur qoftë edhe indicie lidhur me këtë denoncim, në kushtet kur në aktet e administruara në format elektronik nga Komisioni mungon deklarata për kontrollin e figurës. Më tej, Komisioneri Publik parashtroi se referuar nenit 53, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në dukje, denoncimi përmban të dhëna që mund të verifikohen paraprakisht në këtë deklaratë.
21. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet gjatë seancës së parë gjyqësore të datës 06.02.2020, përpos qëndrimit mbi shkaqet e ankimit, dha shpjegime edhe për denoncimin, që i ishte përcjellë për njohje paraprakisht nga Kolegji, më datë 20.01.2020, nëpërmjet postës elektronike.

21.1. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit parashtroi se vëllezërit H. dhe V. C. janë djemtë e dajës së tij. Për punësimin e z. H. C. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka marrë dijëni rastësisht nga familjarët e tij dhe kontaktin e parë me të, pasi kishte filluar punë, e ka pasur disa vite më parë. Për rrjedhojë, aludimi në denoncim mbi ndikimin e subjektit të rivlerësimit në punësimin e z. H. C. nuk ka bazë. Më tej, subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk ka pasur dijëni që z. H. C. ka qenë i dënuar për trafikim të lëndëve narkotike jashtë shtetit, pasi nuk ishte në dijëni as edhe të daljes së tij jashtë shtetit. Edhe për rastin e z. V. C., i cili aktualisht është i punësuar në Itali, subjekti i rivlerësimit parashtroi se ishte informuar nga z. H. C. se vëllai i tij, z. V. C., në fillim të vitit 2018 ishte dënuar me 3 vjet e 10 muaj burg me kusht për mbajtje të lëndëve narkotike, dhe më pas edhe 4 muaj burg për shkelje të detyrimeve të kushtit. Lidhur me këto të dhëna, subjekti i rivlerësimit vendosi në dispozicion të Kolegjit dhe

²⁰ Denoncimi është regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 17.12.2019.

²¹ Denoncuesja kërkoi të verifikohet: i) nëse subjekti i rivlerësimit ka lidhje gjinore me vëllezërit H. e V. C. dhe nëse konfirmohet lidhja, të verifikohet nëse subjekti kishte dijëni për të shkuarën e tyre, dhe nëse ky fakt ishte deklaruar në formularin për kontrollin e figurës në referim të nenit Dh, pika 2 i Aneksit të Kushtetutës; ii) nëse subjekti i rivlerësimit, duke qenë se ka kryer procedurën e njoftimit të fillimit të hetimit disiplinor ndaj denoncueses A. P. për konfliktin e saj me punonjësin e Prokurorisë H. C., ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit; c) rrethanat në të cilat është punësuar H. C. në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Berat, dhe nëse ka pasur ndikim subjekti i rivlerësimit në marrjen e tij në punë apo vazhdimin e marrëdhënies së punës.

pjesëmarrësve të tjerë në gjykim vendimet e gjykatave italiane²². Formularin e kontrollit të figurës, ku detajon se nuk ka familjarë të përfshirë në krimin e organizuar, subjekti e ka nënshkruar në fillim të vitit 2017, në kushtet kur nuk ishte në dijëni të dënimit të H. C., ndërsa vëllai i tij, V. C., rezulton të jetë dënuar pas fillimvitit 2017. Subjekti i rivlerësimit parashtrori se edhe nëse do të kishte qenë në dijëni të dënimit të z. H. C. në vitin 2003, me 7 ditë burgim për mbajtje apo shitje të lëndëve narkotike, do të deklaronte në formular të njëjtën përgjigje negative, duke qenë se kjo vepër penale nuk përfshihet në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

21.2. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit gjendet në konflikt interesi në ndjekjen e hetimit disiplinor që po zhvillohej ndaj saj. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë 27.12.2019, është vënë në dijëni nga prokurori që ndjek praktikën e hetimit disiplinor dhe është njohur për një parashtrësë të datës 24.12.2019 që denoncuesja i ka drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe vetë subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës së tij si drejtues i strukturës që mbulon çështjet e inspektimit. Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor për prokuroren [denoncuesen] A. P. ishte marrë më datë 22.11.2019, mbi një muaj përpara parashtrësës së saj, pas informacionit të përcjellë më datë 09.09.2019, nga drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për shkelje të kryera nga denoncuesja. Fillimi i procedimit disiplinor për prokuroren P. është marrë me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, më datë 11.09.2019. Në cilësinë e tij zyrtare, subjekti ka caktuar një prokuror për të ndjekur praktikën dhe më datë 03.12.2019, ka nënshkruar shkresat përcjellëse të vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores A. P., në adresë të vetë prokurores, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Subjekti i rivlerësimit shtoi se deri më datë 27.12.2019, kur ka ardhur në dijëni të parashtrësës së prokurores, ka firmosur vetëm shkresat përcjellëse të lidhura me vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Deri në atë datë, nuk është angazhuar në asnjë veprim apo të këtë ushtruar ndikim mbi ecurinë e kësaj çështjeje në drejtim të fillimit të hetimit disiplinor ndaj prokurores. Pas njohjes me kërkesën e prokurores, më datë 27.12.2019, subjekti i rivlerësimit deklaroi heqjen dorë për të shmangur çdo lloj paragjykimi të prokurores ndaj tij, pavarësisht se mund të mos gjendej para një situatë të qartë të konfliktit të interesit.

21.3. Në përfundim të parashtrimeve të tij për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit theksoi se aludimet e ngritura nga denoncuesja i konsideron në kundërshtim me vlerat themelore dhe me standardet e rregullat e sjelljes së magjistratit, që venë në dyshim serioz integritetin e saj si prokurore. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit shprehu edhe në konkluzionet përfundimtare të mbrojtjes së tij, të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 03.03.2020, ku theksoi se aludimet e denoncimit janë krejtësisht të pabazuara dhe nuk transmetojnë asnjë provë apo indicie.

21.4. Për të mbështetur shpjegimet e dhëna ndaj pretendimeve në denoncim, subjekti i rivlerësimit vendosi në dispozicion të Kolegjit dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim aktet e mëposhtme.

²² *Shih nënparagrafin 21.4 të këtij vendimi.*

- Informacion nr. {***} prot., datë 09.09.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.
 - Informacion nr. {***} prot. datë 07.01.2020, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.
 - Vendim nr. {***}, datë 22.11.2019, “Fillim procedimi disiplinor” i Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme A. M..
 - Deklarim i subjektit të rivlerësimit për heqje dorë nga çdo praktikë në lidhje me procedimin disiplinor të prokurores A. P., të datës 27.12.2019, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.
 - Informacion, datë 21.01.2020, i H. C. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.
 - Vendim gjyqësor, datë 24.05.2003, i Gjykatës së Qarqeve {***} e {***} Zvicër.
 - Urdhër ekzekutimi për ndërprerjen e burgimit, datë 17.01.2019, i zyrës së ekzekutimit pranë Gjykatës {***}, Itali.
 - Vendim (dispozitiv vendimi), datë 04.10.2019, i Gjykatës së {***}, Itali.
22. Pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me denoncimin e prokurores A. P., trupi gjykues i Kolegjit vendosi me vendim të ndërmjetëm të kryejë hetim gjyqësor bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45, 49, 50 dhe 53 të ligjit nr. 84/2016, dhe kërkoi informacion nga Prokuroria e Përgjithshme²³ dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar²⁴ mbi regjistrimin e mundshëm të ndonjë procedimi penal në ngarkim të z. H. K. C. dhe të z. V. K. C..

22.1. Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë Kolegjit përgjigjet e të gjitha prokurorive pranë gjykatave të të gjitha rrethëve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, si dhe përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Nga dokumentacioni i sjellë nuk rezultoi asnjë procedim penal i regjistruar për z. H. K. C. dhe z. V. K. C..

22.2. Në seancën gjyqësore të datës 26.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të administrojë në cilësinë e provave shkresore përgjigjet e ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të të gjitha rrethëve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm dhe nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

23. Në përfundim të hetimit të kryer dhe pasi shqyrtoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, qëndrimin e Komisionerit Publik, i cili në seancën gjyqësore të datës 26.02.2020 shprehu bindjen për padijeninë e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e kushërinjve të tij në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar, si dhe përgjigjet nga prokuroritë [shtjelluar me hollësi më sipër, në nënparagrafët 22.1 dhe 22.2], trupi gjykues i Kolegjit u bind se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni për faktin e përfshirjes së kushërinjve të tij në veprimtari që bien ndesh me ligjin penal apo që lidhen me krimin e organizuar. Gjatë gjykimit në Kolegj, nuk u provuan fakte të besueshme që mund ta lidhnin subjektin e rivlerësimit me ndikim të mundshëm në punësimin e z. H. C. në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Berat. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që heqja dorë e subjektit të rivlerësimit nga çdo veprim në procedimin

²³ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.02.2020. Kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 19.02.2020, e regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 20.02.2020.

²⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.02.2020. Kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 13.02.2020, e regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 14.02.2020.

disiplinor të prokurores A. P., për të mënjeluar konfliktin e interesit edhe në dukje, sapo është informuar për denoncimin, tregon që në lidhje me situatën faktike të ngritur në denoncim nuk ka elemente nga të cilat mund të ngrihen dyshime për figurën e subjektit të rivlerësimit apo të konkludohet për ushtrim të detyrës në gjendje të konfliktit të interesit. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk konstatoi shkaqe faktike ekzistenca e të cilave do të sillte për pasojë cenimin e vendimit të Komisionit për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit: të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

24. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se kërkimi përfundimtar i Komisionerit Publik për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit mbështetej vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vetëm në njërin prej shkaqeve të ankimit të këtij kriteri, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për shkak se nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës paradhënie prej 1.500.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi në posedim, me sipërfaqe 98 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit shtroi për diskutim nëse në bisedimet për zgjidhjen çështjes do të përfshihen të tria shkaqet e parashtruara në ankim nga Komisioneri Publik apo vetëm shkaku i parashtruar në konkluzionet përfundimtare.
25. Trupi gjykues i Kolegjit, për t’i dhënë përgjigje kësaj çështjeje mori në analizë një sërë dispozitash të parashikuara në legjislacionin e posaçëm që rregullon procesin e rivlerësimit, përkatësisht Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016, si edhe normat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe qëndrimet e shprehura për rolin dhe funksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në procesin e rivlerësimit nga Opinionet e Komisionit të Venecias, si dhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.
26. Në analizë të përcaktimeve ligjore të nenit 179/b, pikat 2 dhe 5 të Kushtetutës²⁵, nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës²⁶, neneve 4, pikat 5 dhe 6²⁷, 5, pika 2²⁸, 63, pika 2²⁹ dhe

²⁵ Neni 179/b, pika 2 e Kushtetutës parashikon se: “Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit”, ndërsa pika 5 e kësaj dispozite parashikon se: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.

²⁶ Neni F, pika 1 i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Kolegji i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit [...]”.

²⁷ Neni 4, pikat 5 dhe 6 të ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “5. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. 6. Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.

²⁸ Neni 5, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.

²⁹ Neni 63, pika 2²⁹ e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Ankimi depozitohet pranë Komisionit që ka dhënë vendimin, sipas nenit 46 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

65, pika 1³⁰ e ligjit nr. 84/2016 , trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë konkluzionin se kuadri ligjor në fuqi e ka parashikuar ngritjen dhe funksionimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit si të vetmen gjykatë të procesit të rivlerësimit. Roli dhe funksioni si e tillë, ka qenë objekt shqyrtimi e vlerësimi edhe i Komisionit të Venecias në opinionet që ai ka dhënë për strukturën ligjore të procesit të rivlerësimit dhe reformës në drejtësi, por edhe në arsyetimet e qëndrimet që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj nr. 2/2017, datë 18.01.2017 dhe nr. 78/2017, datë 12.12.2017.

27. Në opinionin përfundimtar *Amicus Curia nr. CDL-AD (2016)036*, datë 12.12.2016, të Komisionit të Venecias, “Për gjykatën Kushtetuese për ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në paragrafët 13, 39 dhe 40, ndër të tjera, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit shprehet sa vijon.

13. [...] *Megjithëse Kushtetuta ka përcaktuar kompetencën kushtetuese të Kolegjit të Apelimit, duke e konsideruar atë si organ gjyqësor për ankimimin e vendimeve të marra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe që vepron sipas rregullave që zbatohen edhe nga Gjykata Administrative e Apelit [...]*

39. [...] *Opinionin Përfundimtar konstatoi më tej se Komisioni i Posaçëm i Kualifikimit (pra, Kolegji i Apelimit) i ngjan një gjykate në shumë drejtime: anëtarët e tij quhen gjyqtarë, ata funksionojnë brenda Gjykatës së Lartë dhe gëzojnë garanci të ngjashme me garancitë që gëzojnë këta gjyqtarë.*

40. *Për më tepër, sipas nenit 4(6) të Ligjit të Vettingut, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Kushtetuta apo Ligji i Vettingut, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedura që janë të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Shumë prej rregullimeve procedurale të parashikuara në Ligjin e Vettingut që kanë të bëjnë me procedurat para Kolegjit të Apelimit, janë hartuar mbi bazën e cilësimit të këtij procesi si një “proces gjyqësor”, duke qenë se ato parashikojnë zbatimin – ose jo – të rregullimeve që kanë të bëjnë me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (shih, për shembull, nenet 62 (3), 63(2) dhe 65(1) të Ligjit të Vettingut).*

28. Në vendimin nr. 2/2017, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit shprehet sa vijon.

65. *Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit, në vlerësim të dispozitave kushtetuese, rezulton se ato kanë përcaktuar kompetencën kushtetuese të Kolegjit të Apelimit, duke e konceptuar atë si organ gjyqësor për ankimimin e vendimit të KPK-së. Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se “kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”. Gjykata ka theksuar se e drejta themelore e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “[...] nuk mund të*

³⁰ Neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit” ose “[...] nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë”. Ajo duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Kushtetuta i garanton individit të drejtën për t’u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij.

66. Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

29. Në vendimin nr. 78/2017, datë 12.12.2017, Gjykata Kushtetuese për Kolegjin e Posaçëm të Apelit shprehet sa vijon.

40. Në këtë vendim u vlerësua përmbajtja e ligjit nr. 84/2016 edhe në drejtim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Sipas saj, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja dhe KA-ja ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme mbi bazën e parimit të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor dhe, kur është rasti, mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Sipas nenit 47 të ligjit, të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35-40 dhe neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative [...].

41. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se ofrohen të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së (shih paragrafët 66 dhe 67 të vendimit). Për më tepër, gjykata theksoi se në përfundim të procesit të rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar në lidhje me provat dhe arsyet ku është mbështetur, si dhe për përfundimet e nxjerra prej tij (shih paragrafin 55 të vendimit).

30. Mbështetur në këtë kuadër ligjor dhe në jurisprudencën referuese për veprimtarinë e organeve të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se roli dhe funksioni i tij gjyqësor ka një rëndësi të posaçme përgjatë procesit të rivlerësimit, duke synuar garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, në përputhje me parashikimin e nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës. Nga ky funksion kushtetues i Kolegjit të Posaçëm të

Apelimit buron edhe detyrimi i zhvillimit të veprimtarisë së tij si një gjykatë e ngarkuar jo vetëm me zbatimin e legjislacionit të posaçëm që rregullon procesin e rivlerësimit, por gjithashtu e ngarkuar edhe me zbatimin e rregullave bazë procedurale që garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor, edhe në kushtet e një procesi me natyrë administrativo-publike, në të cilin njëri nga palët është Komisioneri Publik, i titulluar nga ligji për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të publikut dhe tjetri subjekti i rivlerësimit.

31. Siç parashikojnë dispozitat e mësipërme, Kolegji i Posaçëm i Apelit vihet në lëvizje dhe ka juridiksion të shqyrtojë ankimet e paraqitura nga palët kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Sipas parashikimit të nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në rastin e ankimeve të paraqitura prej Komisionerit Publik, shqyrtimi i tyre zhvillohet në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, parashikim që nënkupton zbatimin e parimit të kontradiktoritetit dhe zhvillimin e një debati gjyqësor mbi faktet në të cilat janë mbështetur pretendimet e Komisionerit Publik, si edhe mbi faktet në të cilat mbështeten prapësimet e subjektit të rivlerësimit. Zhvillimi i debatit gjyqësor dhe nënshtrimi përgjatë këtij debati i çdo të dhëne që rezulton nga provat e administruara përgjatë hetimit administrativ apo gjatë hetimit gjyqësor, kur ka një të tillë, përfundon sipas nenit 303 të Kodit të Procedurës Civile (*dispozitë që thirret për zbatim nga neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016*) me parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve.
32. Në këto konkluzione pasqyrohet vullneti dhe kërkimi i palëve në reflektim të gjithçkaje që ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, ndaj edhe ligjvënësi ka parashikuar se palët marrin kohë për përgatitjen e tyre dhe se ato si rregull duhet të paraqiten me shkrim. Paraqitja e konkluzioneve përfundimtare, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, nuk është një akt formal që përmbyll procesin gjyqësor, por një mjet procedural në të cilin palët disponojnë mbi të drejtën e tyre për t'iu drejtuar gjykatës me kërkime e pretendime konkrete, të mbështetura në faktet që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor.
33. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmon se përcaktimi në konkluzione përfundimtare prej Komisionerit Publik i vetëm një shkaku ankimi, përcakton edhe vëllimin e çështjeve të cilat duhen trajtuar nga gjykata në bisedime përfundimtare e për të cilat nevojitet që gjykata të japë një përgjigje.
34. Fakti që ky proces paraqet veçoritë e specifikat e tij, të cilat rregullohen në mënyrë të posaçme nga ligji nr. 84/2016, nuk konsiderohet se duhet të shoqërohet me zhveshjen e gjykatës nga tipari i saj thelbësor i arbitrimin e sigurimit të barazisë mes palëve, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 6 i Kodit të Procedurës Civile³¹.
35. Procesi i rivlerësimit ka në përbërje tri institucione të ngarkuara secili me detyrat e kompetencat e tij. Ndër këta, Komisioneri Publik është institucioni që është ngarkuar me përfaqësimin e interesit të publikut, nëpërmjet paraqitjes së ankimeve e përfaqësimit gjyqësor të këtyre interesave përballë subjekteve të rivlerësimit. Zhvillimi i gjykimit publik për t'i dhënë përgjigje interesit të publikut nëpërmjet kryerjes së funksioneve nga Komisioneri Publik, ka për qëllim jo vetëm zgjidhjen e këtyre pretendimeve, por edhe

³¹ Neni 6 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet".

dhënien e mundësisë subjekteve të rivlerësimit që të njihen më to e të mbrohen ndaj këtyre pretendimeve nëpërmjet një procesi të hapur, transparent e të barabartë.

36. Edhe në këtë këndvështrim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se Komisioneri Publik është pala që disponon mbi ankimin, shkaqet e tij dhe kërkimet përfundimtare të cilat duhet të marrin zgjidhje nga gjykata. Evoluimi i qëndrimit të Komisionerit Publik përgjatë gjykimit, si dhe në konkluzione përfundimtare, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, është një proces ligjor dhe logjik i kryer me përgjegjësinë e lartë që kjo detyrë imponon në emër të publikut, për pasojë, është ky subjekt procedural që përcakton vëllimin e çështjeve për të cilat gjykata, në këtë rast Kolegji i Posaçëm i Apelit, duhet të ketë një vendimmarrje.
37. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që çështja e vetme e shtruar për zgjidhje prej tij, e cila do të përcaktonte edhe fatin e kërkimit të Komisionerit Publik për shkarkimin e subjektit nga detyra, ishte vetëm shkaku i ankimit i pretenduar në konkluzionet përfundimtare, siç u përshkrua më lart.

B. Arsyetimi i trupit gjykues mbi shkakun e ankimit që lidhet me origjinën e ligjshme të burimit të të ardhurave prej 1.500.000 lekësh

38. Sipas kërkimit përfundimtar të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës në vlerën 1.500.000 lekë për blerjen e apartamentit në Tiranë. Kjo shumë nuk rezulton të jetë përcaktuar as në kontratën e shitblerjes. Për rrjedhojë, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie. Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, u konstatua sa më poshtë vijon.

38.1. Në deklaratën *vetting*³², subjekti i rivlerësimit shpjegon se pasuria në fjalë, me sipërfaqe 98 m², në vlerë 19.600 USD (dollarë amerikanë), e prenotuar me kontratë porosie individuale të datës 09.02.1998, te firma e ndërtimit “{***}” ShPK, është e pahipotekuar dhe e përfshirë në procedurat e legalizimit. Burim për krijimin e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e krijuara nga kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin “{***}”, dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Korçë, i përfituar nga ligji për privatizimin e banesave. Në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003³³, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me sipërfaqe 100 m², në vlerën 2.600.000 lekë dhe burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit në Korçë [shitur në vlerën 2.500.000 lekë], si dhe kursimet. Nga aktet në fashikull, rezulton se më datë 10.06.2002, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitjes së një apartamenti dhe një shtese banese, të ndodhur në Korçë³⁴, me blerës E. K., kundrejt vlerës 1.000.000 lekë. Sipas kontratës, vlera e shitjes është shlyer jashtë zyrës noteriale.

39. Në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ në Komision³⁵, subjekti i rivlerësimit deklaroi se çmimi i shitjes së kësaj pasurie ishte 2.500.000 lekë dhe blerësi kishte rënë dakord që një pjesë të vlerës t’ia paguante subjektit të rivlerësimit

³² Dorëzuar më datë 27.01.2017.

³³ Dorëzuar më datë 25.03.2004.

³⁴ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

³⁵ Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 12.09.2018 dhe përgjigjet e pyetësorit të datës 21.09.2018.

paraprakisht, në rast se ky i fundit do të lidhte kontratën e porosisë së apartamentit në Tiranë. Pjesa e mbetur e vlerës do t'i kalonte subjektit kur të lirohej banesa në Korçë. Sipas shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit³⁶, apartamenti në Tiranë është shlyer në periudhën kohore shkurt 1998 - mars 2000. Po aty, subjekti i rivlerësimit parashtron se më datë 09.02.1998 ka kryer pagesën 1.900.000 lekë për apartamentin në Tiranë, e vërtetuar me mandatpagesën nr. 2, datë 09.02.1998. Si burim për krijimin e kësaj shume, ka shërbyer kapari prej 1.500.000 lekësh. Pjesën e mbetur prej 1.000.000 lekësh, blerësi e shleu para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes të datës 10.06.2002. Për të provuar pretendimin mbi vlerën e shitjes së apartamentit në Korçë dhe përfitimin e shumës prej 2.500.000 lekësh në dy pjesë, siç shtjellohet më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një deklaratë noteriale të blerësit E. K., të datës 20.08.2018³⁷. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kohën e dhënies së shumës 1.500.000 lekë në formë kapari, së bashku me z. E. K. kanë përpiluar një deklaratë “dore”, ku pasqyrohej veprimi i kryer. Këtë deklaratë, pas nënshkrimit të kontratës më datë 10.06.2002, subjekti i rivlerësimit nuk e disponon. Pjesa e parë e pagesës nuk u shoqërua me akt formal para noterit, duke qenë se ishte në formë kapari. Subjekti i rivlerësimit argumenton se çmimi real i shitjes së pasurisë së paluajtshme në Korçë është plotësisht i justifikueshëm, referuar çmimeve të tregut të kohës, si dhe vendndodhjes së kësaj pasurie. Blerësi do ta përdorte këtë pasuri për ambient biznesi.

40. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka kryer pagesën prej 5.000 lekësh si detyrim tatimor për të ardhurat nga shitja e apartamentit në Korçë, që i korrespondon 0,5% e vlerës 1.000.000 lekë, sipas çmimit të pasqyruar në kontratën e shitjes të datës 10.06.2002 [vërtetuar me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 11.06.2002]. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi se në momentin e hartimit të kontratës së shitjes së apartamentit, i ka shpjeguar noteres mënyrën e pagesës në dy pjesë, përbërë nga kapari prej 1.500.000 lekësh, paguar në shkurt 1998 dhe vlerën 1.000.000 lekë, marrë ditën që po hartohej kontrata [në datën 10.06.2002]. Sipas noteres, ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”³⁸ ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 1999 dhe kapari i përfutur në vitin 1998 përjashtohet nga tatimi, pasi të ardhurat personale të përfutura nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme përpara vitit 1999, nën vlerën 2 milionë lekë, përjashtoheshin nga tatimi. Ndërkohë vlera e tatimit për shitjen e pasurisë së paluajtshme në vlerën 2.500.000 lekë në vitin 2002 përllogaritej në masën 25.000 lekë (1%).

41. Pasi analizoi parashtrimin përfundimtar të Komisionerit Publik, si dhe shpjegimet dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, në konsideratë edhe të akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi marrjen e kaparit në shumën 1.500.000 lekë në vitin 1998, rezultoi me mungesë të burimeve financiare për atë vit dhe nuk mundi të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar prej tij.

41.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se kontrata e datës 10.06.2002, me anën e së cilës është shitur apartamenti në Korçë në vlerën 1.000.000 lekë, është dokument ligjor, i vetmi që provon shumën e të ardhurave të përfutura nga subjekti në momentin e

³⁶ Faqja 1 dhe 3, përgjigjet e pyetësorit të datës 12.09.2018.

³⁷ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

³⁸ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar ka shfuqizuar ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe ligjin nr. 7677, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi fitimin”, me ndryshimet përkatëse, si dhe të gjitha aktet e tjera që vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

shitjes së apartamentit. Në mbështetje të pretendimeve të tij dhe për të kundërshtuar kushtet themelore të pasqyruara në kontratë – kryesisht për të provuar pretendimin se pasuria u shit për vlerën 2.500.000 lekë – subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratën noteriale të vitit 2018 nga blerësi E. K.. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se dokumentet ku mbështetet pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk janë në pajtueshmëri me kontratën e shitjes që përbën provën ligjore. Pretendimet e subjektit për mënyrën e përfitimit të shumës prej 1.500.000 lekësh në vitin 1998, parë përkundër kontratës së shitjes së vitit 2002, mbetën në nivel deklarativ. Ky përfundim i trupit gjykues bazohet së pari në përcaktimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit:

“[...] 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

41.2. Nën dritën e sa më sipër, si dhe të përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që lejon përdorimin si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit të deklaratave të interesave privatë dhe pasurorë, deklarata fillestare e pasurisë e subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, duhet të analizohet në raport me provat e tjera dhe në mënyrë që të shërbejë si themel i vendimmarrjes së Kolegjit, duhet të jetë “[...] në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”³⁹. Në rastin konkret, trupi gjykues i Kolegjit vëren nga njëra anë ekzistencën e një dokumenti zyrtar të pakontestueshëm, lehtësisht i verifikueshëm – kontrata e shitblerjes e datës 10.06.2002 – që i vendos të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga shitja e apartamentit në vlerën 1.000.000 lekë dhe, nga ana tjetër, deklaratën periodike të vitit 2003. Për nga vetë natyra, deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë apo ajo e pasurisë [deklarata *vetting*] janë akte me natyrë deklarimi të njëanshëm. Deklarata noteriale e gushtit 2018 nga blerësi E. K., po ashtu një dokument me natyrë deklarative, është dhënë gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit – pas dorëzimit të deklaratës *vetting* (27.01.2017), gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision⁴⁰ – çka e redukton konsiderueshëm vlerën provuese përkundër kontratës së shitblerjes. Trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kaparin (nenet 601 dhe 602⁴¹) vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit do të ishte bindës nëse në momentin e nënshkrimit të kontratës, palët do të kishin referuar kaparin e dhënë. Në mungesë të marrëveshjes së kaparit në vitin 1998 apo të referimit në kontratë të një shume të konsiderueshme në formën e kaparit katër vjet përpara kontratës së shitjes nga ana e blerësit, ky pretendim mbeti deklarativ.

41.3. Përpos sa më sipër, në vlerësimin e të gjitha parashtrimeve dhe dokumentacionit në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe mungesën e provave të tjera, sikurse dokumente në formën e transfertës bankare, apo çfarëdo dokumenti tjetër zyrtar që në mënyrë qoftë edhe indirekte të provonte pretendimin për kalimin e shumës nga z. K. subjektit të rivlerësimit në sasinë dhe kohën e pretenduar apo të provonte se banesa ishte shitur në fakt me çmimin 2.500.000 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit

³⁹ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

⁴⁰ Shorti për trupin gjykues për rivlerësimin e subjektit, hedhur më 15.01.2018; përgjigjet e pyetësorit të parë tip dërguar nga subjekti daton më 02.02.2018.

⁴¹ Shih poshtëshënimet nr. 13 dhe nr. 14.

konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi përfitimin e shumës përtej asaj të specifikuar në kontratën e shitblerjes, duke qenë se pretendimet e tij mbetën në nivelin deklarativ dhe nuk qenë në harmoni me prova të tjera.

41.4. Së dyti, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar të vetë Kolegjit, e cila ka shtjelluar në mënyrë shteruese rëndësinë vendimtare që përbën provueshmëria me dokumentacion e pretendimeve të ngritura nga subjektet në procesin e vlerësimit të kriterit pasuror. Konkretisht, ky qëndrim është shprehur si në vijim.

“31. [...] I vetmi dokument i sjellë nga subjekti, në procesin e ankimit përpara Kolegjit, ishte një kontratë sipërmarrjeje [...] ndërsa nuk përmban asnjë referencë të subjekti apo bashkëshortja si investitorë apo të përfshirë në çfarëdo cilësie në këtë ndërmarrje. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vlerën dhe kohën e dhënies së shumave të cituara, në formën e investimeve, dhe për mënyrën e fitimit të pronësisë në mënyrë të përzier, *mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion të rregullt ligjor [...]*”⁴².

“[...] 24.3. Për këto arsye, duke mbajtur parasysh [...] faktin që subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti nuk provuan burimin e ligjshëm të të ardhurave që shërbyen si bazë e kësaj pagese [...] referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni dhe të dhënave të përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar në atë fazë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se burimi i ligjshëm për sa i përket shumës prej 720.000 lekësh, pretenduar nga subjekti dhe përfituar në tejkallim të detyrimit të ish-bashkëshortit për regjim ushqimor, *mbeti i paprovuar me dokumentacion të rregullt ligjor [...]*”⁴³.

“[...] 84. Nuk rezulton që të jetë e provuar shuma ose të ardhurat e pretenduara [...], të cilat nuk janë provuar me dokumentacion justifikues për një periudhë janar-korrik 1995, si dhe transfertat bankare për pagesat e shoqërisë {***}. Nga aktet e administruara në fashikull nuk rezultojnë të jenë provuar të ardhura të tjera të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrime tatimore në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 19, neni 3 i ligjit nr. 84/2016, të cilat, ashtu siç edhe subjekti sqaron, janë realizuar në të zezë [...]. Kështu, sa i përket burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës *ato mbesin në nivel deklarativ dhe nuk justifikohet ligjshmëria e tyre nga ana e subjektit të rivlerësimit [...]*”⁴⁴.

“[...] 22. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues pasi i vlerësoi provat e sipërcituara, në mënyrë individuale si dhe në tërësinë e tyre, në raport edhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti në Komision, si dhe me pretendimet e ngritura në ankim, arrin në përfundimin se Komisioni ka konstatuar në

⁴² Shih vendimin nr. 19/2019, datë 26.07.2019.

⁴³ Shih vendimin nr. 14/2019, datë 09.07.2019.

⁴⁴ Shih vendimin nr. 9/2018, datë 24.10.2018.

mënyrë të drejtë situatën faktike nëpërmjet provave të marra në shqyrtim, duke arritur në konkluzionin se *nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor* ekzistenca e një marrëdhënieje punësimi midis bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit S. B, ku punëmarrësi ofron shërbimin e rënë dakord dhe punëdhënësi, në respektim të legjislacionit në fuqi, kundërshtëpërblen punëmarrësin nëpërmjet pagës, si dhe i garanton atij të gjitha të drejtat e tjera [...]⁴⁵.

41.5. Në vijim të analizës së mësipërme lidhur me vlerën provuese të deklarimeve periodike të interesave pasurorë të bëra nga subjektet, parë kundrejt provave të tjera dhe dokumentacionit shkresor, në raste kontradiktash mes të parave dhe provave të tjera, Kolegji ka vendosur bazuar në dokumentacion, duke i gjetur deklaratimet e subjekteve jobindëse nëse binin ndesh me logjikën dhe gjuhën e ligjit. Me fjalë të tjera, në çështje me problematika të ngjashme, kur subjektet e rivlerësimit kanë kërkuar që deklarimeve periodike vjetore të kryera prej tyre, të pashoqëruara me dokumentacion, t'u jepet vlerë provuese vendimtare, Kolegji ka vlerësuar se pretendimet për gjendje të caktuar financiare, pavarësisht se janë deklaruar, bëheshin nga subjektet e rivlerësimit në funksion të shpjegimit të pamundësisë së justifikimit të shpenzimeve të kryera me burime të ligjshme⁴⁶.

41.6. Nëpërmjet jurisprudencës së tij, Kolegji ka shtjelluar se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur janë elemente përcaktuese për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë⁴⁷.

41.7. Siç është shtjelluar më sipër (paragrafët 41.1 dhe 41.2), pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfitimin e shumës prej 1500000 lekësh nga z. E. K., bie ndesh me kontratën e shitjes. Ndërsa, sa i përket kaparit, e drejta materiale civile nuk përcakton detyrime të formës për palët, procesi i rivlerësimit, për shkak të specifikës së tij, mbështetet tërësisht në provueshmërinë e fakteve dhe të dhënave mbi dokumentacion justifikues ligjor, ndërsa subjektet e rivlerësimit kanë barrën të provojnë pretendimet e tyre, nën dritën e nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Në zbatim të këtyre dispozitave, për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, siç përcakton neni 32 i ligjit nr. 84/2016. Mënyra e zbatimit të këtyre dispozitave shtjellohet më tej në udhëzimin nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁴⁸, sipas të cilit çdo burim i deklaruar për çdo lloj pasurie në pronësi të

⁴⁵ Shih vendimin nr. 7/2019, datë 05.04.2019.

⁴⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 20/2019, datë 31.07.2019 dhe referimin direkt të tij në vendimet nr. 7/2019 dhe 11/2019, si dhe vendimin e Kolegjit nr. 11/2019, datë 22.05.2019, ku edhe dokumentacioni mbështetës në fashikull, depozituar nga subjekti i rivlerësimit, u çmua si i pamjaftueshëm për të provuar burimet e ligjshme të të ardhurave të pretenduara. [Paragrafi 27.12.17].

⁴⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 5/2019, nr. 6/2019, nr. 9/2019, nr. 13/2019, nr. 19/2019 etj.

⁴⁸ Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, "Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e

subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, në kuadër të procesit të rivlerësimit, duhet të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor, në momentin e fitimit⁴⁹. Ky detyrim ligjor për funksionarët zyrtarë në Republikën e Shqipërisë, për të provuar pretendimet pasurore me dokumentacion, pasqyron një përgjegjësi për individët edhe në aktet e dala në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, shtjelluar në Udhëzuesin Teknik të kësaj të fundit⁵⁰.

41.8. Prapësimet e subjektit të rivlerësimit, siç arsyetohet në paragrafët pararendës, të cilat në mungesë të provave dokumentare nuk arritën të kapërcejnë natyrën deklarative, nuk mund të zhbëjnë një dokument me vlerë të plotë ligjore, siç është kontrata e shitjes në rastin konkret. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjendet në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, detyrim i parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrjen e shumës në vlerën 1.500.000 lekë në vitin 1998, nga z. E. K., në formën e kaparit.

41.9. Nga ana tjetër, edhe nëse pranohet për efekt të arsyetimit në të kundërt pretendimi i subjektit të rivlerësimit se apartamenti u shit me një çmim që ishte 150% më shumë se ai që rezulton në kontratën e shitjes së datës 10.06.2002, për shkak të kaparit të paguar më herët, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se çmimi në kontratë u sugjerua nga noterja dhe lidhej me detyrimet tatimore që shoqërojnë transaksionet e pasurive të paluajtshme, nuk ishte bindës. Gjatë procesit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit depozitoi një mandatpagesë, sipas së cilës ka paguar më datë 28.01.2020 shumën 24620 lekë tatim. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *vetting* në janar 2017, është i papranueshëm dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin.

41.10. Duke marrë në konsideratë analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe atë të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë parashtrimeve të tij në Kolegji, në kushtet kur marrja e shumës prej 1.500.000 lekësh në vitin 1998 mbeti në nivel deklarativ, pasi binte ndesh me dokumentacionin ligjor, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së të ardhurave të ligjshme për të kryer pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes së pasurisë së paluajtshme në Tiranë.

42. Në analizë të shkaqeve të ankimit të parashtruara në konkluzionet e Komisionerit Publik, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi të gjitha provat e marra gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ato të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në Kolegji, trupi gjykues i Kolegjit konkludon sa më poshtë.

lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë":

<http://www.ildkpi.al/rregullore-dhe-udhezime/>.

⁴⁹ Shih pika 7 e udhëzimit.

⁵⁰ Udhëzuesi Teknik për Konventën e UN kundër Korrupsionit:

(https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/TechnicalGuide/09-84395_Ebook.pdf), faqe 25-26, ku, ndër të tjera "[...] zyrtarët mbajnë përgjegjësi të shpjegojnë burimet e të ardhurave të tyre [...]".

42.1. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, ashtu edhe gjatë gjykimit në Kolegj, rezulton se nuk arriti të justifikojë me dokumentacion marrjen e kaparit në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, shumë e cila sipas subjektit të rivlerësimit është përdorur prej tij për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit prej 98 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë.

42.2. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare dhe nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar prej tij, duke kryer deklaram të pamjaftueshëm, të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pika 3 dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Adnan Kosova.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.03.2020.

ANËTARE

ANËTARE

ANËTAR

NATASHA MULAJ

REZARTA SCHUETZ

ARDIAN HAJDARI

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi

RELATORE

KRYESUES

INA RAMA

SOKOL ÇOMO

nënshkrimi – kundër

nënshkrimi – kundër

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, kemi mendim paralel kundrejt shumicës së trupit gjykues lidhur me vlerën procedurale që përfaqëson konkluzioni përfundimtar, në raport me shkaqet e ankimit të depozituara nga Komisioneri Publik, në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova. Në vlerësimin tonë, fjala përfundimtare/konkluzioni përfundimtar nuk prevalon në asnjë rast kundrejt ankimit fillestar. Për sa kohë ankimi fillestar qëndron, fjala përfundimtare, me gjithë rëndësinë që ka për përmbylljen e procesit, nuk zhbën shkaqet e ankimit.
2. Në rastin konkret, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi ankimin e Komisionerit Publik nr. 77/6 prot., datë 13.02.2019, bazuar edhe në Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 29.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova. Në ankim, Komisioneri Publik kërkoi vlerësimin e të tria kriterëve, por fokusi kryesor ishte vlerësimi i kriterit të pasurisë.
3. Në këtë kontekst, lidhur me kriterin e pasurisë, ankimi i Komisionerit fokusohet kryesisht në tri çështje që lidhen me:
 - a. origjinën e ligjshme të shumës 1.500.000 lekë që subjekti i rivlerësimit pretendoi ta ketë përfituar në formën e kaparit;
 - b. shmangien e pagesës së detyrimit tatimor prej subjektit të rivlerësimit për vlerën e përfituar nga shitja e apartamentit – sipas tij, kjo vlerë ishte 2.500.000 lekë;
 - c. pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të disponuar shumën prej 1.900.000 lekë, përdorur për pagesën për blerjen e një apartamenti në Tiranë, në vitin 1998.
4. Të tria këto çështje ligjore përbëjnë aspekte të ndryshme të rrethanave që lidhen me një fakt: blerjen e një apartamenti në Tiranë, në vitin 1998, në vlerën 19.600 USD, me fonde të prejardhura nga shitja një apartamenti [në Korçë] në vitin 2002 – në vlerën 1.000.000 lekë, sipas kontratës ose 2.500.000 lekë, sipas subjektit.
5. Në fjalën përfundimtare, duke marrë në fokus sërish kriterin pasuror, si edhe në ankim, Komisioneri Publik kërkoi shkarkimin e subjektit. Me atë rast, Komisioneri Publik parashtroi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion pretendimin e tij për arkëtimin nga blerësi të një shume prej 1.500.000 lekësh që në vitin 1998 dhe, për pasojë, nuk provoi pagesën e apartamentit në Tiranë me burime të ligjshme të të ardhurave. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe duhet të shkarkohet. Trupi gjykues i Kolegjit, me shumicë votash, vendosi të pranojë këtë kërkesë të Komisionerit. Ne jemi dakord me pranimin e kësaj kërkesë të Komisionerit Publik dhe ishim pjesë e shumicës dhe votuam për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
6. Vlerësimi ynë se shkaqet e ankimit dhe fjala përfundimtare janë pjesë e një tërësie, mbështetet në leximin harmonik të një sërë parimesh dhe dispozitash të zbatueshme. Së pari, asnjë dispozitë e ligjit nr. 84/2016 nuk i njeh vlerë procedurale fjalës

përfundimtare të subjekteve ose Komisionerit Publik. I vetmi mjet procedural që krijon premisat e përfshirjes së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në procesin e rivlerësimit, është ankimi. Në rregullimet procedurale të juridiksionit të rivlerësimit, Kushtetuta dhe Aneksi i saj parashikojnë ankimin nga Komisioneri Publik ose subjektet e rivlerësimit përkatësisht në nenin 179/b, pika 5 dhe nenet B, pika 3, germa “c”; C, pika 2 dhe F, pika 2. Po ashtu, ligji nr. 84/2016 parashikon ankimin dhe vënien në lëvizje të Kolegjit në të njëjtin juridiksion⁵¹, në shtatë (7) dispozita kryesisht. Asnjë dispozitë në këtë kuadër ligjor nuk referon në konceptin e bisedimeve përfundimtare, adoptuar nga procedura civile si kuadër normativ i radhës së tretë në procesin e rivlerësimit. Edhe në dispozitat procedurale civile, konkretisht nenet 302 dhe 30, përkundër rregullimeve specifike për mënyrën sesi kryhen dhe dokumentohen ankimet, afatet, përmbajtjen, legjitimitimin e palëve në ngritjen e një ankimi, sa u përket bisedimeve përfundimtare, ligji përcakton vetëm momentin kur kryhen dhe radhën që ndjekin palët. Elementet e formës janë jotaksativë.

7. Arsyetimi, sipas të cilit bisedimet përfundimtare zhbëjnë kërkimet në ankim, është i pabazuar në ligj. Ky përfundim bëhet edhe më i qartë nëse sjellim në vëmendje që neni 302 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që, si rregull, palët duhet të jenë në gjendje të japin konkluzionet përfundimtare menjëherë pas mbylljes së hetimit gjyqësor – shtesa e afatit prej 5 ditësh është vetëm si përjashtim dhe nëse kërkohet nga palët. Në këtë këndvështrim, dhënia bisedimeve përfundimtare e një peshe kaq vendimtare për fatin e kërkimeve të palëve në një proces të zakonshëm civil, të atillë sa të zhbëjë potencialisht edhe shkaqet e ankimit apo parashtrimet e palëve gjatë gjithë procesit – nëse pranohet logjika e shumicës – ndërkohë që palët priten të jenë gati të parashtrajnë konkluzionet përfundimtare sapo ka përfunduar hetimi gjyqësor, duket e palogjikshme. Duke qenë se në procese civile palët jo gjithmonë përfaqësohen nga avokatë, rezervimi i një peshe vendimtare fjalës përfundimtare përkundër shkaqeve të ankimit, bëhet edhe më i vështirë të pranohet.
8. Në procesin e rivlerësimit, në të cilin aktet e pranuar në cilësinë e provës janë jo rrallë të shumta, me detaje teknike dhe dokumentacion mbështetës voluminoz, që kërkon analizë të kujdesshme nga palët, rezervimi i bisedimeve përfundimtare, një koncepti procedural civil që përfshin si rregull palë private, i një peshe procedurale me përparësi kundrejt shkaqeve të ankimit, është i pabazuar edhe në specifikën e procesit të rivlerësimit. Në këndvështrimin parimor, reduktimi i argumenteve të Komisionerit Publik në fjalën përfundimtare, pa arsyetuar rrethanat ligjore mbështetëse, nuk përputhet edhe me qëllimin që Kushtetuta i njej rolit të Komisionerit Publik si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit dhe kontraston me rregullimin e nenit B, pika 3, germa “c” e Aneksit të saj, sipas të cilit Komisioneri Publik duhet të arsyetojë rastet kur nuk bie dakord me rekomandimin e vëzhguesit ndërkombëtar për të ushtruar ankim.
9. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, si gjykatë administrative, zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë/subjekteve të rivlerësimit. Nëse në një proces tipik civil, mosparaqitja e palëve mund të sjellë edhe pushimin e gjykimit, shqyrtimi në Kolegji nuk ndikohet nga

⁵¹ Referencë në juridiksionin e rivlerësimit përkundër juridiksionit disiplinor të Kolegjit të parashikuar nga neni 179, pika 7 e Kushtetutës dhe neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

mungesa e palëve. Ky parashikim procedural administrativ është në sinkroni edhe me objektivin e procesit të rivlerësimit, që është *kthimi i besimit të publikut te drejtësia*.

10. Për arsyet e mësipërme, jemi kundër mendimit të shumicës që redukton objektin e gjykimit të çështjes në konkluzionet përfundimtare të parashtruara nga Komisioneri Publik, dhe jo në vlerësimin tërësor të shkaqeve të ankimit dhe të çështjes në tërësi, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik Darjel Sina kundër vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), vendim i cili kishte konfirmuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshëm subjektin e rivlerësimit Adnand Kosova. Në konkluzion të qëndrimit tonë, kemi votuar kundër vendimit nr. 5, datë 13.03.2020, të marrë prej shumicës së trupit gjykues për ndryshimin dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur qëndrimin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi duhej të lihej në fuqi.
2. Në arsyetimin tonë të qëndrimit kundër, së pari do të duhet të saktësojmë çështjet për të cilat u dakordësua dhe u ftua të votojë trupi gjykues në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar në seancë publike gjyqësore, në zbatim të nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016), si edhe qëndrimin e mbajtur prej nesh pas hetimit të kryer mbi një denoncim nga publiku, të paraqitur pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), ndaj subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova.
3. Siç rezulton edhe nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të marrë prej shumicës, trupi gjykues në këtë çështje zhvilloi hetimin gjyqësor në zbatim të nenit F, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me denoncimin e paraqitur në Kolegj kundër subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar dhe marrë në cilësinë e provës në drejtim dhe për qëllim të verifikimit të informacioneve të përcjella nëpërmjet denoncimit, si aktet shkresore të paraqitura prej vetë subjektit të rivlerësimit, edhe aktet shkresore të përcjella prej Prokurorisë së Përgjithshme, në zbatim të vendimit të gjykatës për të kërkuar informacione të mëtejshme.
4. Në përfundim të hetimit gjyqësor, palët deklaruan pretendimet e tyre duke kërkuar respektivisht:

Komisioneri Publik: *Ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 90, datë 20.12.2018, dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, pasi për pasurinë apartament banimi në posedim, me sipërfaqe 98 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me vlerë 19600 USD, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës paradhënie prej 1500.000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit 98 m². Si rrjedhim, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm burimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 98 m², duke kryer kështu deklaram të pamjaftueshëm, për pasojë kërkohet shkarkimi i tij nga detyra, në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.*

Subjekti i rivlerësimit: *Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 90, datë 20.12.2018, dhe konfirmimin në detyrë.*

5. Sikundër edhe shumica e trupit gjykues, pakica do të japë qëndrimin e saj në këtë mendim kundër në lidhje me këtë çështje, e cila mbeti shkaku i vetëm i ankimit për të cilin Komisioneri Publik kërkoi përfundimisht shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, për shkak të qëndrimit tonë në lidhje me shkakun e mësipërm, të ndryshëm nga qëndrimi që ka mbajtur shumica dhe në funksion të ezaurimit të të gjitha çështjeve që u shtruan për zgjidhje për të gjitha kriteret e procesit të rivlerësimit, për sa kohë që qëndrimi ynë në lidhje me shkakun e ankimit të çonte drejt lënies në fuqi të vendimit të konfirmimit në detyrë të subjektit, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, do të

analizojmë edhe rezultatet e hetimit dhe qëndrimin tonë në lidhje me denoncimin e paraqitur në Kolegj.

I

6. Në vlerësimin e pakicës, shkak i ankimit i pretenduar nga Komisioneri Publik se përbën një shkak shkarkimi në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron.
Pakica ka bërë një vlerësim dhe çmim të ndryshëm nga shumica të rrethanave të faktit që lidhen me provueshmërinë e përfitimit të një shume prej 1500000 lekësh prej subjektit të rivlerësimit në vitin 1998, si kapar që do të siguronte realizimin e kontratës së shitblerjes mes tij dhe blerësit E. K., të shtëpisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, të ndodhur në qytetin e Korçës. Pakica në analizë të të gjitha rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë gjithë procesit, krijon bindjen se kjo shumë parash është përfituar prej subjektit në kohën dhe mënyrën e deklaruar prej tij, për pasojë e konsideron të provuar krijimin në mënyrë të ligjshme të kësaj shume dhe përdorimin e saj si një prej burimeve të pagimit të kësteve të paguara prej subjektit në vitin 1998, për prenotimin e shtëpisë së banimit prej 98 m², të ndodhur në Tiranë.
7. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në posedim një apartament banimi me sipërfaqe 98 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati i {***}, Shk. {***}, Ap. {***}. Ky apartament, i cili është edhe shtëpia e vetme e banimit e subjektit të rivlerësimit, është prenotuar me kontratë porosie individuale të datës 09.02.1998, te shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, me kontratën me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.1998. Ai është i paregjistruar ende në regjistrat Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por ndodhet në proces legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Vlera e apartamentit është 19.600 USD, e përcaktuar si e tillë edhe në kontratën e mësipërme të porosisë⁵².
Subjekti rezulton se ka deklaruar si burim të të ardhurave për këtë apartament:
 - (i) të ardhurat e krijuara nga kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes ndër vite;
 - (ii) të ardhurat e krijuara nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin “{***}”, {***};
 - (iii) të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Korçë, i përfituar nga ligji mbi privatizimin e banesave.
8. Të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Korçë, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, janë krijuar në dy faza: shuma prej 1500000 lekësh në vitin 1998, kohë në të cilën ai u dakordësua me blerësin E. K. për shitjen e shtëpisë në Korçë dhe kur kjo shumë iu dorëzua subjektit si një kapar për sigurimin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së banesës në një kohë të mëvonshme, kur subjekti i rivlerësimit do të kishte mundësi të lironte fizikisht banesën që e përdortë për familjen e tij deri në sistemimin e saj në apartamentin e porositur në Tiranë. Pjesa tjetër e të ardhurave prej 1.000.000 lekësh është krijuar në vitin 2002, kur subjekti ka realizuar kontratën e shitblerjes së banesës në Korçë. Sipas deklarimeve të subjektit, shuma prej 1.500.000 lekësh, e përfituar prej tij në vitin 1998 si kapar ka shërbyer së bashku me kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga pagat, për të paguar dy këste të prenotimit të apartamentit në Tiranë, në të cilin ai dhe familja e tij banon edhe sot.
9. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankimin e paraqitur kundër vendimit objekt shqyrtimi dhe në konkluzionet përfundimtare të këtij procesi gjyqësor, se subjekti i

⁵² Kjo kontratë porosie individuale e datës 09.02.1998 ka të specifikuar se çmimi i shitjes së apartamentit nr. {***}, në katin {***}, me sipërfaqe 98 m², është me vlerë 19.600 USD.

rivlerësimi nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e kaparit në shumën prej 1.500.000 lekësh në vitin 1998 dhe, për pasojë, ai gjendet në kushtet e mosprovimit të burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë, pikërisht për këtë shumë.

10. Në vlerësimin e pakicës, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi e konkluzioni të Komisionerit Publik, në kuadër të të gjitha rrethanave të faktit që kanë rezultuar nga hetimi i zhvilluar në këtë çështje dhe në kontekst të kuadrit ligjor në fuqi që rregullon çështjet e ngritura, Kolegji duhet të shtronte dhe zgjidhte dy çështje, që do të analizohen më poshtë.
 1. Përcaktimi i dokumentacionit ligjor të detyrueshëm për të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në funksion të provimit të ekzistencës së marrëdhënies së pretenduar të kaparit.
 2. Përcaktimi i vlerës provuese të dokumentacionit të administruar me cilësinë e provës dhe analiza dhe çmuarja e çdo fakti që ka rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit, në funksion të krijimit të bindjes së brendshme të gjykatës, mbi të cilën duhej të merrte përgjigje pretendimi përfundimtar i Komisionerit Publik.
11. *Në lidhje me çështjen e parë*, pakica vlerëson të nënvizojë faktin se marrëdhënia e kaparit e pretenduar se është lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe blerësit të shtëpisë në Korçë, z. E. K., është një marrëdhënie juridike e parashikuar nga dispozitat e Kodit Civil, në Titullin III “Mjetet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve”, në nenet 601 e 602 të tij.

Në nenin 601 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet definicioni dhe elementet e kësaj marrëdhënieje, përcaktohet se: *Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.*
12. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë⁵³ ka pranuar nëpërmjet vendimmarrjeve të saj se kontrata e kaparit mund të lidhet jo vetëm për të siguruar ekzekutimin e një kontrate të lidhur, por edhe për të garantuar detyrimin e lidhjes së një kontrate të dakordësuar mes palëve në të ardhmen, siç është rasti i pretenduar prej subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, pretendimi i Komisionerit Publik se, sipas parashikimit ligjor, kapari duhet të konsiderohet si një kontratë dytësore e një kontrate që ka ekzistuar dhe është lidhur, dhe në rastin konkret nuk rezulton që në kohën e lidhjes së kontratës së pretenduar të kaparit

⁵³ Gjykata e Lartë, me vendimin e saj nr. 11118-00014-00-2009 i regj. dhe nr. themeltar 00-2013-2270 i vendimit (556) me vendimin e saj të datës 10.10.2013 ka arsyetuar se:

“17. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë sjell në vëmendje të gjykatave të faktit se, në vështrim të përmbajtjes së neneve 601 dhe 602 të Kodit Civil, kapari ka një funksion të dyfishtë: (i) të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe (ii) të sigurojë përmbushjen e saj. Në këtë drejtim kapari konfirmon qenien e kontratës (arrha confirmatoria), që për rastin në shqyrtim konfirmon qenien e kontratës së datës 15.02.2005, prej së cilës palët kanë tërhequr të drejtat dhe kanë marrë përsipër detyrime konkrete.

17.1. Kapari është një ndër mjetet e sigurimit të përmbushjes së detyrimeve, që në ndryshim nga të tjerët, siguron jo vetëm përmbushjen e detyrimit, por edhe vetë lidhjen e kontratës. Në kuptim të dispozitave të sipërtreguara të Kodit Civil, ndonëse kontrata e kaparit është kontratë dytësore (aksesore), ajo përbën dhe një sanksion civil ndaj palës që është me faj, si për rastin e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, ashtu dhe kur për faj të njëjës palë nuk lidhet kontrata kryesore. Në këtë kuptim, gjykatat gabojnë kur e konsiderojnë kontratën e lidhur midis palëve të pavlefshme.

17.2. Kontrata e kaparit, në dallim nga kontratat e tjera dytësore, mund të ekzekutohet edhe më vite. Ajo mund të lidhet edhe për një detyrim të lindur apo edhe për një kontratë që nuk është lidhur. Pra, ndonëse quhet kontratë dytësore, ajo mund të mos jetë dytësore e një kontrate, por e një detyrimi, sikurse është rasti në shqyrtim, që kontrata midis palëve është lidhur për përmbushjen e një detyrimi, atë të lidhjes në të ardhmen të kontratës së shitjes.”

të ishte lidhur vetë kontrata e shitjes, për pasojë, ligjërisht nuk mund të ekzistonte as kapari, vlerësojmë se është një pretendim që nuk është i bazuar ligjërisht, duke argumentuar në vlerësimin tonë se fakti që në vitin 1998, në të cilin pretendohet se është lidhur kontrata e kaparit, nuk ka ekzistuar vetë kontrata e shitjes, nuk është një argument ligjor që përjashton mundësinë e ekzistencës së kontratës së kaparit në atë kohë.

Sipas vlerësimit të pakicës, pikërisht kontrata e kaparit e lidhur në këtë kohë do të siguronte që palët të respektonin dhe të gjendeshin të detyruar nëpërmjet pasojave ligjore që parashikon neni 602 i Kodit Civil, të lidhnin në të ardhmen kontratën e dakordësuar e të premtuar të shitblerjes. Në këtë kuptim, ne vlerësojmë se ligji nuk ka parashikuar ndonjë detyrim për palët që kontrata e cila duhet të sigurohet me kapar, t'i paraprijë në kohë në kuptimin formal vetë kontratës së kaparit.

13. Duke arsyetuar si më sipër, çështja tjetër e natyrës ligjore që shtrohet për zgjidhje në funksion të dhënies përgjigje të shkakut të ngritur prej Komisionerit Publik, është parashikimi i detyrimit ligjor për formalizmin apo lidhjen e kontratës së kaparit në një formë të caktuar ligjore, qoftë për efekt vlefshmërie apo provueshmërie.
14. Në analizë të parashikimeve ligjore që rregullojnë formën e veprimeve juridike, nuk gjenden në Kodin Civil dispozita që rregullojnë apo kërkojnë një formë të caktuar ligjore për kontratën e kaparit. Vetë dispozitat që rregullojnë këtë kontratë, nenet 601 e 602 të Kodit Civil, ometojnë një formë të caktuar sipas së cilës vullneti i palëve për lidhjen e kësaj kontratë duhet të shfaqet duke lënë të kuptohet se rregullat për formën e kësaj kontrate do të jenë rregullat e përcaktuara në pjesën e përgjithshme të Kodit Civil, të cilave u nënshtrohen të gjitha llojet e veprimeve juridike që kryhen mes palëve në qarkullimin civil.
15. Në këtë linjë arsyetimi, në këndvështrim të nenit 80 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial*, si edhe neni 83 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm* – është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera që nuk përfshihen në këtë dispozitë, veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë, për pasojë, arrihet në konkluzionin se kontrata e kaparit e pretenduar si e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit E. K., është një nga ato kontrata që mund të lidhet në secilën prej formave që neni 81 i Kodit Civil parashikon për kryerjen e veprimeve juridike, me shkrim, me gojë ose me çdo formë që tregon në mënyrë të padyshimtë vullnetin e palëve për kryerjen e këtij veprimi juridik.
16. Forma shkresore nuk është një formë e detyrueshme për vlefshmërinë e kontratës së kaparit në këndvështrim të dispozitave të përmendura më lart, për pasojë pakica çmon se nuk ka një dokumentacion ligjor të detyrueshëm e të mirëpërcaktuar apo të lidhur me ndonjë pasojë ligjore për vlefshmërinë e kontratës, të cilën subjekti duhet detyrimisht ta kishte kryer në kohën e pretenduar se ka lidhur kontratën e kaparit, mungesa e të cilit e vë subjektin në pamundësinë ligjore për të provuar ekzistencën e kësaj kontrate duke përdorur burimet e tjera të provave. Në kuptim të nenit 83, pika 3 e Kodit Civil, subjekti i rivlerësimit do të mund të gjendej në vështirësi për ta provuar këtë marrëdhënie me dëshmitarë, në rast të një konflikti të supozuar kundërshtie mes tij dhe blerësit E. K., por do të mund të përdorte pavarësisht burimet e tjera të provave, sipas Kodit të Procedurës Civile, për ta provuar atë. Në procesin e rivlerësimit, në vlerësimin tonë ky rregull procedural, tipik për proceset kontradiktore të natyrës civile, nuk është një rregull i zbatueshëm pa kufizim, por i zbatueshëm në përshtatje e në përputhje me qëllimin e natyrën e veçantë të këtij procesi e në funksion të arritjes së provueshmërisë së fakteve e

ngjarjeve të vendosura brenda kontekstit të këtij procesi me natyrë administrative-publike.

17. Në vijim të këtij arsytimi, veçojmë faktin se një burim i rëndësishëm prove në kuptim të këtij procesi është deklarata periodike e pasurisë, e cila është parashikuar nga neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 në mënyrë të shprehur si një dokument me vlerë provuese për këtë proces dhe për më tepër Kolegji ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar e koherent rreth vlerës provuese të këtij dokumenti në kuadër të këtij procesi, në të gjitha vendimet e dhëna prej tij. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, duhet të trajtohet deklarata fillestare e pasurisë së përpiluar nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2003, në të cilën ai ka deklaruar për herë të parë marrëdhënien me pasurinë apartament, të ndodhur në rrugën “{***}”, duke përcaktuar si vlerë të blerjes së saj shumën prej 2.600.000 lekësh dhe si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga shitja e shtëpisë në Korçë dhe kursimet, duke përcaktuar edhe vlerën e shitjes së apartamentit në Korçë, për 2.500.000 lekë.
18. Në këto kushte, duke përdorur konkluzionet e mësipërme, në vlerësimin tonë nuk qëndron pretendimi i Komisionerit Publik dhe qëndrimi i shumicës së trupit gjykues se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor marrëdhënien e kaparit të lidhur në vitin 1998, vetëm për shkak të mungesës së një kontrate të nënshkruar prej palëve e të lidhur posaçërisht prej tyre në funksion të dokumentimit të kësaj marrëdhënieje, aq më tepër kur në mbështetje të këtij pretendimi të subjektit vjen përmbajtja apo informacioni që sjell deklarata fillestare e pasurisë së cituar më lart.
19. *Në lidhje me çështjen e dytë*, pakica ka vlerësuar se në mungesë të një detyrimi për një formë të posaçme për lidhjen e kontratës së kaparit, analiza që u bëhet të gjitha të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të provave sipas përcaktimeve të posaçme të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të krijojnë bindjen se kjo marrëdhënie ka ekzistuar dhe se deklarimi i subjektit se ai ka përfituar shumën prej 1.500.000 lekësh prej ekzekutimit të saj, është i saktë dhe i vërtetë.
Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Adnand Kosova dhe blerësi E. K. kanë lidhur kontratën shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., në datën 10.06.2002, për kalimin e pronësisë së banesës së subjektit të ndodhur në qytetin e Korçës, duke përcaktuar në përmbajtjen e saj se çmimi për shitjen e kësaj prone është 1.000.000 lekë dhe se ai është shlyer jashtë zyrës noteriale.
20. Subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetjeve të Komisionit se në të vërtetë çmimi i shitjes ka qenë 2.500.000 lekë dhe pjesa prej 1.500.000 lekësh e marrë si kapar, nuk është shënuar në kontratë, sipas këshillës së noterës publike⁵⁴ pranë së cilës është bërë kontrata, pasi asaj i ishin shpjeguar rrethanat e faktit.
21. Ndryshe nga sa ka pranuar shumica e trupit gjykues, pakica ka një vlerësim të ndryshëm të rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi në lidhje me këtë situatë, të cilat do të analizohen më poshtë, pa përsëritur në mënyrë sistematike çdo të dhënë që gjen pasqyrim në vendimin e shumicës, por duke vlerësuar të dhënat në raport me njëra-tjetrën e sipas një vlerësimi objektiv e ligjor që na ka krijuar bindjen për saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit.
22. Së pari, vlen të theksohet se dispozita ligjore sipas së cilës ne kemi vlerësuar vlerën e çdo prove në kuptim të këtij procesi, është neni 49 i ligjit nr. 84/2016, i titulluar “Mjetet e kërkimit të provës”, i cili parashikon se:
 1. *Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë:*
 - a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2 e këtij ligji;

⁵⁴ *Noteres pranë Dhomës së Noterisë Korçë, Zh. I.M.*

- b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku;
- c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumenteve të marra nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; [...]
3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji, nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.
4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit në bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.
23. Në çështjen objekt gjykimi, mbështetur në nenin 681 të Kodit Civil, i cili parashikon se kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si edhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës, vlera e provuesë e kontratës së shitblerjes për sa i përket çmimit të shitjes, duhet të vlerësohet dhe çmohet duke e interpretuar atë sipas qëllimit të palëve. Në këtë këndvështrim për shkak të një sërë rrethanash të cilat kanë rezultuar nga hetimi e që nuk mund të injorohen e të konsiderohen si joekzistente në kushtet kur ato burojnë nga burime të njohura të provës, sipas parashikimeve të neneve 32, pika 5 e 49 të ligjit nr. 84/2016, por edhe për faktin se ato japin informacione të arsyeshme dhe të pranueshme nga logjika, të cilat, të çmuara në raport me njëra-tjetrën, të çojnë në konkluzionin se kontrata e shitblerjes e vitit 2002, për sa i përket vlerës së përcaktuar për çmimin e banesës, nuk përfaqëson vlerën reale të çmimit të shitjes së pronës, por një vlerë të dakordësuar mes palëve se duhej të paguhej atë moment, pakica ka çmuar të përdorë për të interpretuar dhe kuptuar domethënien e kësaj vlere prej 1.000.000 lekësh, në funksion të qëllimit dhe vullnetit që pala shitëse, subjekti i rivlerësimit, dhe pala blerëse kanë pasur në momentin e përpilimit të këtij akti. Organet e rivlerësimit dhe vetë Kolegji i Apelit ka pranuar në jurisprudencën e tij⁵⁵ të diskutojë dhe të konsiderojë të pavërteta elementet e deklaruara në kontrata të ndryshme në të cilat kanë marrë pjesë subjektet e rivlerësimit, pavarësisht faktit se ato kanë qenë deklarime të bëra para një noteri publik dhe nuk kanë qenë kontestuar prej palëve, pikërisht se për shkak të veçorisë së këtij procesi të përmendur edhe më lart, jo me natyrë civile të pastër, vlerësimi dhe gjykimi i çështjeve mund të bëhet në zbatim të normave procedurale të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të zbatueshme në përputhje me parashikimin referues që bën neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, duhen konsideruar edhe dispozitat e Kodit Civil për interpretimin e kontratave, për sa kohë që vetë palët deklarojnë një qëllim të caktuar në përpilimin e tyre në formën dhe përmbajtjen që rezulton se kanë, por edhe për shkak se ky qëllim i deklaruar i palëve mbështetet nga të dhënat e përfuara nëpërmjet burimeve të tjera të provës, siç përshkruhen në këtë mendim.
24. Me të njëjtin pushtet diskrecional, pakica e trupit gjykues vlerëson se edhe në rastin konkret, ekzistojnë disa të dhëna që vijnë jo vetëm nga shpjegimet e subjektit, por nga burime të njohura provash që konsiderohen të besueshme në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, e që e bëjnë të interpretueshëm çmimin prej 1.000.000 lekësh, të përcaktuar në kontratën e shitblerjes si çmimi i shitjes së banesës në Korçë.
25. Argumenti i parë në këtë drejtim mbështetet në deklarinimin fillestar që subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9043/2003”), ka kryer për pasurinë e tij, ku deklaroi se apartamentin në Korçë e ka shitur me vlerën totale prej 2,5 milionë lekësh. Vlera e kësaj

⁵⁵Referojuni vendimeve të Kolegjit nr. 10/2018 (JR), datë 19.11.2018; nr. 10/2019 (JR), datë 18.04.2019; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019.

deklarate, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet si një provë me vlerë të posaçme provuese, mbi të cilën është mbështetur në një mënyrë të rëndësishme i gjithë procesi i kontrollit të pasurive të subjekteve dhe i verifikimit të deklarimeve të tyre, në kuptim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, është e rëndësishme sepse jep informacion origjinal e të pamanipuluar në funksion të këtij procesi, përpos që demonstroi koherencën ose jo të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në raport me deklaratimet e pasurisë së tij në vite. Përpos vlerës ligjore të deklarimeve periodike të përcaktuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, vlen të theksohet edhe fakti që në rastin konkret jemi përpara deklaratimit fillestar të subjektit të rivlerësimit, në fillimet e një procesi i cili për shkak të të panjohurave të tij, presupozohet se ka përfutur deklaratime të vërteta jo vetëm në drejtim të legjitimitetit të ndonjë pasurie, por edhe në drejtim të justifikimit të pasurive të deklaruara. Në këtë kontekst, për sa kohë që përgjatë procesit të rivlerësimit, subjektet përgjigjen për deklaratimet e bëra në vite, në të njëjtën mënyrë ata duhet të vlerësohen edhe për sa i përket koherencës dhe logjikës që shoqëron deklaratimet e tyre në vite.

26. Në drejtim të verifikimit të këtij deklarimi të subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, i cili është mbështetur edhe nga deklarimi në deklaratën *vetting*, por edhe nga shpjegimet e dhëna prej tij përgjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni ka vijuar hetimet duke i kërkuar ZRVPP Korçë, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.10.2018, informacion mbi çmimin mesatar të shitjes, si dhe çmimin e referencës për apartamentin e zonës kadastrale nr. {***} të qytetit të Korçës, në vitet 2002 dhe 1998, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka dakordësuar termat e kontratës së shitjes dhe ka kryer edhe kontratën e shitblerjes. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, me shkresën me nr. {***} prot., datë 02.11.2018, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, informon mbi çmimin minimal fiskal të apartamenteve se:
- çmimi minimal fiskal për apartamente në qytetin e Korçës për vitin 1998 ka qenë 25.145 lekë/m²;
 - çmimi minimal fiskal për apartamente në qytetin e Korçës për vitin 2002 ka qenë 29.635 lekë/m².
27. Në referim të këtyre çmimeve, që vlen të theksohet se përfaqësojnë çmimet minimale fiskale, dhe jo domosdoshmërisht çmimin real të shitjes në periudhat respektive, të cilat natyrshëm, por edhe për shkak të fakteve të njohura botërisht nga Kolegji, janë gjithmonë më të larta se këto të referuara si minimale, rezultoi se banesa, pronë e subjektit në qytetin e Korçës, do të duhej të ishte shitur minimalisht në vitin 1998 për vlerën 1913535 lekë dhe në vitin 2002 në vlerën 2.255.224 Lekë. Të dyja këto vlera janë shumë më afër vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si çmim i shitjes së banesës dhe shumë larg, në një raport aspak logjik dhe të arsyeshëm, me vlerën e shënuar në kontratën e shitjes prej 1.000.000 lekësh.
28. Përveç sa më sipër, pakica e sheh të drejtë të sjellë në vëmendje edhe një referim tjetër të një standardi ligjor të përdorur tashmë në procesin e rivlerësimit, në drejtim të përcaktimit të kostos së ndërtimit apo tregtimit për objekte të ndryshme, kryesisht ndërtime informale, në pronësi të subjekteve të rivlerësimit, në rastet kur ka qenë e pamundur të provohet vlera e saktë e kostos së këtyre objekteve apo edhe në rastet kur ka pasur dyshime për vërtetësinë e deklarimeve të vlerave të këtyre ndërtimeve, të bëra në kontrata të ndryshme për kalimin e pronësisë. Ky referim lidhet me çmimet e kostos apo tregtimit sipas Entit Kombëtar të Banësave⁵⁶. Sipas këtyre çmimeve të bëra publike

⁵⁶ Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 16.10.2002, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banësive nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave në tregun e lirë të banësive dhe të Koeficientit "K"".

me shpalljen në faqen zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave⁵⁷, e të konsideruara prej pakicës së trupit gjykues, si fakte të njohura botërisht, në zbatim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se çmimi i tregut i banesës së subjektit të rivlerësimit në vitin e shitjes 2002, do të ishte në vlerën prej 2920414 lekësh.

29. Në vijim të fakteve të mësipërme, vlen të theksohet edhe deklarimi i dhënë nga blerësi i pronës E. K në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2018, e cila është administruar si provë nga Komisioni, duke i refuzuar subjektit të rivlerësimit kërkesën për pyetjen e drejtpërdrejtë të këtij shtetasi, me cilësinë e dëshmitarit. Në deklarimin e tij, blerësi i pronës, deklaron të njëjtat fakte të pretenduara e të deklaruara prej subjektit. Në kushtet kur sipas arsyetimit të bërë në çështjen e parë, sipas vlerësimit tonë, kapari si një marrëdhënie juridike mund të bëhej në çdo formë, ky deklarim i palës tjetër të përfshirë vetë në marrëdhënie, merr vlerë provuese për sa kohë që lidhet dhe është në harmoni edhe me rrethanat e tjera të përshkruara më lart. Pretendimi se një kontratë e lidhur mes palëve jo para ndonjë autoriteti publik si noteri do të kishte më shumë vlerë provuese, nuk është një argument ligjor i mbështetur nga dispozitat ligjore në fuqi, por vetëm një vlerësim që çdo trup gjykues do të duhej t'i bënte një situatë të tillë rast pas rasti, në varësi të rrethanave specifike të çdo çështjeje. Në rastin konkret, kjo mënyrë të deklaruarit e të provuarit e këtij fakti dhe jo përpjeka për të fabrikuar ndonjë akt që do të justifikonte kryerjen e këtij veprimi në një kohë tjetër, e parë dhe e vlerësuar në raport me faktet e tjera, e bën, sipas vlerësimit tonë, të besueshëm dhe me vlerë provuese deklarimin e këtij shtetasi.
30. Në vijim të këtij arsyetimi, gjendet i besueshëm edhe shpjegimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë për sa i përket arsyes së mosdeklarimit të të gjithë shumës në kontratën e shitjes, por vetëm shumën e marrë në atë moment, referuar konfuzionit dhe paqartësisë mbi legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë në ato vite, i cili kishte pësuar ndryshime, të cilat, në mungesë të akteve normative që do të mund të detajonin rregullimet e ligjit, çmohet si një arsye e pranueshme për t'i dhënë shpjegim mospasqyrimin në kontratën e shitblerjes së të gjithë vlerës së çmimit.
31. Në përfundim të këtij arsyetimi, ne kemi krijuar bindjen, në analizë të fakteve si më sipër, se vlera e shitjes së apartamentit të Korçë nuk mund të ketë qenë ajo prej 1.000.000 lekësh, e përshkruar në kontratën e shitjes, dhe se deklarimi i subjektit për çmimin e shitjes prej 2.500.000 lekësh, vlerësohet se është i vërtetë për sa kohë mbështetet nga faktet që rezultojnë nga burime të tjera të njohura. Në të njëjtën logjikë, mbështetur në faktet e përshkruara e analizuara më sipër, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tonë është i besueshëm edhe deklarimi i subjektit për ekzistencën e marrëdhënies së kaparit në vitin 1998 dhe përfitimin prej kësaj marrëdhënieje të shumës prej 1.500.000 lekësh, shumë e cila ka shërbyer për të shlyer detyrimin financiar në drejtim të shoqërisë “{***}” ShPK, si pagesë për prenotimin e apartamentit prej 98 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë. Në konkluzion, kemi çmuar se ashtu siç palët kanë deklaruar, si edhe të dhënat që burojnë nga provat e tjera kanë mbështetur në harmoni me njëra-tjetrën, vlera prej 1.000.000 lekësh e përshkruar në kontratën e shitblerjes së vitit 2002, përfaqëson jo vlerën e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, por vetëm vlerën e paguar nga blerësi në momentin e përpilimit të kontratës si diferencë mes çmimit të shitjes prej 2.500.000 lekësh dhe kaparit të paguar për të siguruar realizimin e kësaj kontrate prej 1.500.000 lekësh, në vitin 1998.
32. Përfundimisht, për të gjitha arsyet e mësipërme, duke vlerësuar të gjitha provat e analizuara më sipër, e mbështetur në bindjen e brendshme, në zbatim të rregullit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, kemi arritur në konkluzionin se shkak i ankimit për të cilin Komisioneri Publik kërkon ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, nuk është i mbështetur në prova e në ligj.

⁵⁷ <http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>

II

33. Në lidhje me rezultatet e hetimit të fakteve të pretenduara në denoncimin e paraqitur nga publiku, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pakica gjen të drejtë dhe ndan të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur nga shumica në arsyetimin e vendimit, sipas të cilit asnjë fakt i pretenduar në denoncim nuk u provua se ishte i tillë që të afektonte vlerësimin që Komisioni kishte bërë për subjektin e rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës.
34. Në përfundim të këtij arsyetimi, ne, gjyqtarët në pakicë të trupit gjykues, kemi konkluduar se nuk ka rezultuar i mbështetur në prova e në ligj as pretendimi i Komisionerit Publik për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit dhe as pretendimet e përcjella në denoncimin i cili u bë objekt i hetimit gjyqësor. Për këto arsye, nuk kemi gjetur asnjë shkak të ligjshëm për të ndryshuar vendimin nr. 90, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për pasojë kemi votuar që ai të lihet në fuqi.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi